

CALL YOUR COUNTRY
 FOL ME VENDIN TËND
 DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.
WIND
 Informacione në wind.it



E PËRMUAJSHME/MENSILE VITI/ANNO VI NR.8 - SETTEMBRE/SHTATOR 2009 - € 1,50

shqiptari i italisë

l'albanese d'italia

CALL YOUR COUNTRY
 FOL ME VENDIN TËND
 DUKE FILLUAR NGA 10 CENT/MIN.
WIND
 Informacione në wind.it

BOTA SHQIPTARE - Il Mondo Albanese Edizioni - Redazione Viale Marco Polo 119, 00154 Roma - Tel 06.57289240 Fax 06.62209543



Rastësitë fatlume të KLODIAN DEDËS



SANATORIA KA FILLUAR

Nga 21 gushti ka nisur pagesa e e kontributit prej 500 eurosh të parashikuar për legalizimin e marrëdhënieve të punës të kategorisë 'colf e badanti' dhe, për rrjedhojë, edhe të klandestinëve të punësuar nga familjet



WESTERN UNION
 MONEY TRANSFER

Promovim i madh Mercatone Uno për të gjithë lexuesit!
 Në gazetë gjen një bonus zbritjeje çmimi 20 € për një shpenzim prej të paktën 100 € të vlefshëm në pikat e shitjes Mercatone Uno!

Q uhet "Deklarim i aktivitetit të asistencës dhe të mbështetjes familjare" sanatoria për bashkëpunëtorët familjarë që u miratua me ligjin e njohur si "Paketa anti-krizë" (ligji nr. 102 i 3 gushtit 2009). Siç e thotë edhe në emër, ka të bëjë me legalizimin, përmes vetë-deklarimit të punëdhënësve, të punës në të zezë të dy kategorive të punonjësve familjarë, që njihen me termat colf e badanti. Sanatoria është për të gjithë punonjësit e këtyre kategorive që punojnë në të zezë, qofshin këta italianë, komunitarë, apo të huaj, me apo pa lejen e qëndrimit.

Punëdhënësit që mund të paraqesin deklaratën, pra që do të kërkojnë sanatoren për marrëdhënien e parregullt të punës, mund të jenë italianë, komunitarë, ose jokomunitarë, por këta të fundit vetëm nëse kanë kartën e qëndrimit ose lejeqëndrimin BE për qëndruesit afatgjatë. Mund të legalizohen në këtë mënyrë bashkëpunëtorët shtëpiake që më 30 qershor 2009 ishin të punësuar në të zezë nga punëdhënësit prej të paktën 3 muajve: pra marrëdhënia e punës duhet të ketë filluar jo më vonë se 1 prilli 2009. Deklarimi i punësimit në të zezë kushton 500 euro për çdo punonjës e mund të paraqitet nga nga 1 deri në 30 shtator. Kështu, përpara paraqitjes së deklaratës punëdhënësi duhet të paguajë më parë këtë shumë, në bankë apo në postë, duke përdorur modelin "F24 - Versamenti con elementi identificativi" (F24-Derdhje me elemente identifikimi) të Agjencisë së të Ardhurave. Dita e parë e vlefshme për këtë pagesë ishte 21 gushti, ndërsa dita e fundit e mundshme është pikërisht 30 shtatori që është edhe data e fundit e vlefshme për paraqitjen e deklaratimit.

Edhe pse nga sanatoria mendohet të përfitojnë nga 500 mijë

SANATORIA ka filluar

Pikat kryesore të "Deklarimit të aktivitetit të asistencës dhe të mbështetjes familjare", siç quhet ndryshe sanatoria për bashkëpunëtorët shtëpiake e miratuar me dekretin anti-krizë të miratuar më 3 gusht

NGA 21 GUSHTI KA NISUR PAGESA E E KONTRIBUTIT PREJ 500 EUROSH TË PARASHIKUAR PËR LEGALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE TË PUNËS TË KATEGORISË 'COLF E BADANTI' DHE, PËR RRJEDHOJË, EDHE TË KLANDESTINËVE TË PUNËSUAR NGA FAMILJET MODELIN F24 DHE PROGRAMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR PARAQITJEN E KËRKESAVE I GJENI EDHE NË shqiptariitalise.com

deri në 750 mijë bashkëpunëtorë familjarë, gjatë ditëve të fundit të gushtit nuk ka pasur asnjë radhë për derdhjen e kësaj shume. Dhe fakti që familjet janë ende me pushime e që për pagesën janë plot 40 ditë në dispozicion, e justifikon këtë gjë. Duhet thënë gjithashtu që lexues në qytete të ndryshme të Italisë kanë sinjalizuar mungesën e modeleve "F24 - Versamenti con elementi identificativi" në banka e posta. Edhe ky është problem që mund të kapërchet lehtë: ky model F24 mund të shkarkohet edhe nga faqet internet të gazetës (shqiptariitalise.com), si dhe nga website-t e disa institucioneve si Agjencia e të Ardhurave, INPS, Ministria e Brendshme etj.

Gjëja më e rëndësishme është që sanatoria për bashkëpunëtorët familjarë nuk ka asnjë kufizim: do të pranohen të gjitha kërkesat e paraqitura brenda afatit të përcaktuar, me kusht që të përmbushen kushtet e përcaktuara nga



SANATORIA COLF E BADANTI

Disa pika që duhen mbajtur parasysh:

nuk do të përpilohet asnjë lloj renditjeje në rend kronologjik të paraqitjes së kërkesave ndaj edhe ato të paraqitura më 30 shtator do të kenë të njëjtat shanse si ato të paraqitura më 1 shtator;

përpilimi dhe nisja on-line e modularëve janë krejtësisht falas;

në rast të mosparaqitjes së dokumenteve apo në rast se nuk përmbushen kushtet e parashikuara me ligj, kërkesa do të refuzohet;

në rast mosmarrjeje, arkivimi, apo refuzimi të kërkesës, kontributi prej 500 eurosh nuk do të kthehet;

nëse dokumentacioni i paraqitur do të jetë i paplotë, mund të kërkohej integrimi i tij, duke caktuar një datë të re takimi;

mosparaqitja në takim, pa motive justifikuese, sjell automatikisht arkivimin e kërkesës;

paraqitja e deklaratës për legalizim të punës në të zezë nënkupton heqjen dorë nga kërkesa për nulla-osta për punë të varur të paraqitur për një punonjës përmes flukseve 2007, 2008;

procedimet penale dhe administrative lidhur me shkeljen e normave mbi hyrjen dhe qëndrimin e parregullt në territorin italian (me përjashtim të nenit 12 të Tekstit Unik për Imigracionin) pezullohen nga data e ardhjes në fuqi të normave deri në përfundimin e praktikës së legalizimit të punës. Nënshkrimi i kontratës së qëndrimit, bashkë me komunikimin e detyrueshëm të punësimit në INPS, dhe lëshimi i lejes së qëndrimit sjellin për punëdhënësin e për punëmarrësin zhdikjen e veprës penale dhe të shkeljeve administrative.

SANATORIA HAP PAS HAPI

Punëdhënës të interesuar

Mund të kryejnë deklaratën për legalizim të marrëdhënies së punës punëdhënësit që punësojnë dikë në të zezë, të paktën, prej tre muajsh më datë 30 qershor, dhe që janë:

Shtetas italianë;

Shtetas të BE-së rezidentë në Itali;

Shtetas jokomunitarë me kartën e qëndrimit;

Familjarët jokomunitarë të një shtetasi të BE-së që kanë kartën e qëndrimit.

Ministria e Brendshme, një libër udhëzimesh on-line



Për t'i shpëtuar gjobës dhe dëbimit, nuk do të jenë të paktë ata që kundrejt një "shpërblimi" (natyrisht, mbi 500 eurot që i duhet paguar shtetit) do të gjejnë një familje që të deklarojë se i ka pasur në punë prej aq muajsh sa kërkon norma, dhe të përfitojnë nga sanatoria. Nuk është për t'u çuditur që pas sanatores do të rritet përqindja e burrave të punësuar si 'colf e badanti' kategori që është thujse tërësisht femërore.

ligji. Nga sanatoria mund të përfitojnë edhe ata që në të shkuarën janë dëbuar sepse nuk kishin dokument qëndrimi, apo e kishin atë të skaduar. Por nuk mund të përfitojnë prej saj të gjithë ata që janë dëbuar për motive të sigurisë, të rendit publik apo terrorizmi, ata që janë "të papranueshëm në Itali", që janë dënuar, qoftë edhe vetëm në shkallë të parë të gjyqimit, për krime për të cilat parashikohet arrestimi në flagrancë (për shembull, zhvatje, vjedhje etj).

Si paraqitet kërkesa

Për punonjësit italianë apo komunitarë, kërkesa e legalizimit të marrëdhënies së punës paraqitet drejtpërdrejt në INPS me anë të modulareve të posaçëm. Për punonjësit jokomunitarë, deklarimi i punësimit në të zezë i paraqitet on-line Sportelit Unik për Imigracionin përmes modulareve që shkarkohen me pro-

gramin e posaçëm të ministrisë së Brendshme nga faqet internet interno.it ose në ato të gazetës shqiptariitalise.com.

Çdo familje mund të legalizojë maksimumi 2 kujdestare dhe një punëtores shtëpie (1 colf dhe 2 badanti).

Kush paraqet kërkesë për legalizimin e një punëtores shtëpie (colf) duhet të ketë të ardhura vjetore për vitin 2008 prej të paktën 20 mijë eurosh, nëse në familjen e tij asnjë tjetër nuk ka të ardhura; dhe 25 mijë euro nëse në familje kanë të ardhura dy apo më shumë pjesëtarë të saj.

Nuk parashikohet asnjë kufizim të ardhurash për vënie në rregull të kujdestareve (badanti), por në këtë rast është e domosdoshme certifikata mjekësore e një strukture shëndetësore publike ose e mjekut të familjes që të dëshmojë kufizimin e vetëmjaftueshmërisë së personit që ka nevojë për asistencë. Edhe nëse ky person ka nevojë për dy kujdestare, duhet të

dëshmohet në certifikatë.

Kërkesat për kujdestare mund të paraqiten nga vetë personi që ka nevojë për asistencë ose nga një familjar i tij (edhe nëse nuk bashkëjeton me të). Kështu për shembull, dikush mund të legalizojë kujdestaren e babait edhe nëse nuk bashkëjeton me të, duke paraqitur certifikatën mjekësore të atit që dëshmon kufizimin e aftësive të këtij të fundit.

Edhe kush ka paraqitur kërkesë për flukset e hyrjeve 2007 ose 2008 mund të bëjë deklarin e legalizimit të marrëdhënies së punës. Kush zgjedh këtë rrugë, pra që të përfitojë nga sanatoria, heq dorë nga kërkesa për flukset, që arkivohet automatikisht nga Sporteli Unik për Imigracionin.

Deri në përfundim të shqyrtimit të deklarinëve, punonjësi nuk mund të dëbohet, dhe as ai e as punëdhënësi nuk mund të jenë objekt procedimesh penale dhe administrative për shkelje të normave mbi imigracionin dhe

Shifrat e sanatores

Sipas ministrisë së Brendshme, pritet që me këtë sanatore të përfitojnë nga 500 mijë deri në 750 mijë bashkëpunëtorë familjarë që sot punojnë në të zezë, kryesisht të huaj dhe pa dokumente qëndrimi.

Falë taksës una tantum që duhet paguar për legalizimin e çdo marrëdhënieje pune dhe pullë-taksës prej 14,62 eurove, brenda shtatorit, pritet që në arkat e shtetit të hyjnë nga 257 milionë deri në 386 milionë euro.

Për të mos përmendur çka do të hyjë më pas kur këta të huaj të kërkojnë lejen e qëndrimit që sot kushton 72,62 euro, por me miratimin e paketës së sigurisë do të kush-tojë edhe shumë më tepër.

punën. Këto shkelje do të falen përfundimisht nëse legalizimi përfundon me sukses.

Pasi verifikohet që kërkesa është e pranueshme, sporteli unik, thërret punëdhënësin e punonjësin për lidhjen e kontratës së qëndrimit. Nga ky çast punonjësi do të mund të kërkojë lëshimin e lejes së qëndrimit. Leja qëndrimit kërkohet në postë me anë të formularëve të gatshëm. Deri më sot kushton 72,12, por me siguri do të jetë edhe më e kripur kur ministria e Brendshme dhe ajo e Ekonomisë të vendosë sa do të jetë vlera e kontributit që paketa e re e sigurisë parashikon nga 80 deri në 200 euro.

Po të paraqiten deklarata të rreme, si për shembull kur marrëdhënia e punës as që ka ekzistuar, apo ka nisur pas datës 1 prill 2009, kryhet krim, dhe po të përdoren dokumente të falsifikuara, rrezikohen deri në 6 vjet burg.

Avv. Mascia Salvatore

Kushtet për legalizimin e marrëdhënies së punës

Përndihmësit shtëpiakë - Colf

Mund të paraqesin kërkesë punëdhënësit me të ardhura vjetore, për vitin 2008, jo më të ulëta se 20 mijë euro në rast se familja ka të ardhura vetëm nga një pjesëtar i saj.

Ndërsa, në rast se në bërthamën familjare ka disa pjesëtarë që përfitojnë të ardhura, ato duhet të jenë të paktën 25 mijë euro.

Mund të paraqitet vetëm një kërkesë për çdo bërthamë

familjare.

Për kujdestarët për persona me patologji apo me aftësi të kufizuara - Badanti

Mund të paraqesin kërkesë personat që mund të demonstrojnë kufizimin e vetëmjaftueshmërisë - të tyren apo personit për të cilin kërkohet asistencë - në çastin kur ka lindur marrëdhënia e punës, përmes një dokumentacioni të lëshuar nga një strukturë shëndetësore publike apo një mjek i autorizuar nga Shërbimi Shëndetësor Kombëtar. Për qytetarët

të cilëve u është njohur më parë invaliditeti, do të jetë e mjaftueshme të paraqesin dokumentin e invaliditetit civil.

Mund të paraqiten deri në dy kërkesa për bërthamë familjare. Në rast se paraqiten dy kërkesa për të njëjtin person, dokumentacioni mjekësor duhet të dëshmojë këtë nevojë.

Pra çdo bërthamë familjare do të mund të kërkojë, maksimumi, legalizimin e punësimit të tre punonjësve (1 colf dhe 2 badanti).

Procedura

Kur, sa dhe si paguhet

Para se të nisë procedura e legalizimit on-line, është e nevojshme të paguhet kontributi prej 500,00 eurosh për çdo punonjës. Kjo shumë mund të paguhet duke filluar nga 21 gushti, përmes modelit "F24 - versamenti con elementi identificativi" që mund të gjendet në faqet internet www.agenziaentrato.gov.it, www.interno.it, www.lavoro.gov.it, www.inps.it. Në model shënohen kodet

vijon në faqen 5

Sanatoria, ku të kërkojmë ndihmë

Të gatshme patronatet, komunitat, shoqatat e privatët. Falas dhe me pagesë

Edhe pse ministria e Brendshme siguron që nuk nevojitet të jesh gjeni i informatikës për të paraqitur kërkesën për sanatore, janë të shumtë punëdhënësit që kërkojnë ndihmë. Dhe do ta gjejnë pa shumë probleme.

Për të përpiluar e nisur on-line kërkesën mund t'u drejtohen për shembull, patronateve. "Këtë herë nuk do të ketë probleme, edhe për faktin që nuk ka garë "kush arrin i pari", ndaj puna do të organizohet përgjatë gjithë muajit shtator" thotë Pino Giulia, përgjegjësi imigracioni i patronatit Acli. Që thekson: "do të bëjmë gjithçka falas, nuk do të jetë e detyrueshme as kuota e regjistrimit". Ofrojnë ndihmën e tyre edhe komunitat. "Nuk japim vetëm informacione mbi kushtet dhe procedurën, por mund të nisim edhe kërkesat. Është një shërbim falas për të gjithë punëdhënësit, mjaft që të kenë rezidencën në komunën tonë" thotë Gianluca Cassuto, i Zyrës për të huajt e komunës San Donato Milanese.

Rrjeti i asistencës përfshin edhe shoqatat e kategorisë, që edhe në të shkuarën ishin autorizuar të nisnin kërkesat e flukseve. Por në këtë rast nevojitet regjistrimi: "Shërbimi është falas, por vetëm për anëtarët tanë" konfirmojnë në numrin e gjelbër të Assindatcolf, sigël sindikale i punëdhënësve shtëpiakë.

Ndërkohë janë vënë në lëvizje edhe privatët: avokatë, ekonomistë, konsuletë pune e qendra shërbimesh, u ofrojnë asistencë të plotë -natyrisht kundrejt një pagese - atyre që duan të legalizojnë marrëdhënien e punës së punëtorëve shtëpiake dhe kujdestareve. Ofertat janë të ndryshme, nga nisja e thjeshtë e kërkesës deri të konsulenca e plotë; po ashtu edhe çmimi, mund të shkojë nga 50 euro deri mbi 1.000, natyrisht përveç 500 eurove të taksës una tantum.

Zyrat në pritje të bombës me emrin sanatore

Sportelet Unike dhe Kuesturat janë sot të mbytura me praktika të prapambetura. Si do t'u përgjigjen qindra mijëra kërkesave të sanatores?

Sanatoria ende nuk ka nisur por të gjithë flasin për qindra mijëra kërkesa. Në zyrat nëpër të cilat do të kalojnë praktikantët ende nuk thihet atmosfera e panikut, por të gjithë e kanë mëse të qartë që me personelin aktual, sanatoria nuk do të jetë një punë as e lehtë e as e shpejtë. Në Romë, një nga qytetet më të nxehta, nuk janë optimistët. "Kjo sanatore bie mbi shpatulla zyresh që kanë tashmë punë të prapambetur të konsiderueshme, dhe besoj se kjo situatë nuk është vlerësuar mjaftueshëm" denoncon Adelaide Benvenuto, sindikalist Fp Cgil në prefekturën e kryeqytetit. "Jemi mësuar të punojmë në situatë të jashtëzakonshme e do të vazhdojmë ta bëjmë, por kështu nuk mund të zhdukim punën e prapambetur"

Me bllokimin e punësimeve të reja, edhe zyrave të imigracionit u duhet t'ia dalin me personelin që kanë. "Në Sportelin Unik për Imigracionin - vazhdon Benvenuto - thujse i gjithë personeli është i punësuar me kohë të kufizuar, janë ata të agjencive interinale që kanë marrë konkursin, dhe të tjerë si ata, me vend pune të paqëndrueshëm. Është e vështirë të përballohet vëllim i madh pune me personel të tillë, të përgatitur padyshim, por të pastabilizuar".

"Sanatoria është një rast unik, ndaj t'ia besosh një profesionisti është një garanci. Verifikojmë një nga një kushtet, përgatisim kërkesën, e nisim dhe ndjekim klientin deri në nënshkrimin e kontratës së qëndrimit. bësoj se mund të ofrojmë një shërbim më të personalizuar e më të kualifikuar se sportelet falas" thotë avokata Ledia Mirakaj nga studioja e saj në sheshin Vittorio në Romë. Nuk është dakord me avokaten Maurizio Bove, përgjegjësi imigra-

Nuk janë më mirë zyrat e Kuesturës, që duhet të kontrollojnë nëse ka motive penguese për legalizimin e çdo të huaji, si një dëbim për arsye sigurie apo sinjalizim si "person i padëshirueshëm" në Itali.

"Ky kontroll është vetëm njëra anë e medaljes, sepse më pas, të gjithë ata që do të përfitojnë nga sanatoria do të kërkojnë lejen e qëndrimit. Kjo do të thotë qindra mijëra kërkesa të reja, kur Roma, Milanoja, Brescia e kuestura të tjera janë të mbytura edhe nga vëllimi i tanishëm i punës" thotë Enzo Mario Letizia, sekretar i Shoqatës Kombëtare të Funkionarëve të Policisë.

Edhe policia nuk do të ketë shtim organike për sanatoren. "Jemi në vështirësi të mëdha. I njëjti agjent që sot punon me praktikantët e imigracionit, nesër shkon në stadium për të mbajtur rendin publik, e pasnesër i hipën makinës për kontrollin e territorit. S'dimë më cilës çështje t'i japim përparësi" vazhdon Letizia.

Është e lehtë të imagjinohet që këtë situatë do të edhe familjet e punonjësit që do të kërkojnë marrjen e dokumenteve me sanatoren. Sa kohë do t'u duhet të presin për të marrë një përgjigje?

Elvio Pasca

cioni në Cisl-in e Milanos: "Ne këshillojmë të gjithë t'u drejtohen sporteleve që ofrojnë asistencë falas, është shërbim publik nga i cili ia leverdis të përfitohet. Fakti që të tjerë kërkojnë para nuk do të thotë që ofrojnë kualitet më të mirë. Mbi të gjitha -përfundon Bove - nuk duhet pasur besim te ata që ofrojnë zgjidhje të lehta për raste të pazgjidhshme, si për shembull ata që ofrojnë punësime të rreme".

Elvio Pasca

MESAZH PROMOVIMI

MERCATONE UNO

Asortiment i shumëllojshëm, leverdi, cilësi, kujdes për klientët: këto janë disa nga karakteristikat e Mercatone Uno, një nga realitetet më të rëndësishme në sektorin e Shpërndarjes së Gjerë jo-ushqimore në Itali, leader në shitjen e mobilieve dhe të plotësuesve të mobilimit, me një asortiment të gjerë produktesh për shtëpinë. Nga viti 1983 deri më sot, historia e Mercatone Uno-s është në rritje të vazhdueshme: një rrjet prej mëse 100 pika shitjesh, një asortiment gjithnjë e më i shumëllojshëm mobilieve dhe plotësuesish mobilimi, me mëse 20.000 mijë artikuj për shtëpinë dhe kohën e lirë, me reparte të specializuara për të përbushur çdo nevojë ("Oro" për bizhuterinë, "Phone Point" për celularët, "Gran Relax" për shitjen e dyshekëve, "Borsari Sport" për artikujt sportivë). E me të gjithë avantazhin e cilësisë së lartë dhe çmimeve të pranueshme..

Që nga lindja e tij, grupi Mercatone Uno ka bërë të vetat disa vlera themelore:

Oferta konkurruese

Mundësi e madhe zgjedhjeje dhe cilësi për të gjitha produktet e për të gjithë brezat e çmimeve

Shërbime me cilësi

Për Mercatone Uno-n është e rëndësishme t'u shërbejë mirë klientëve të vet. Kjo do të thotë që garanton cilësinë e shërbimeve në çdo çast: kujdes për klientelën në fazën e blerjes, disponibilitet i produkteve, shpejtësi në dorëzim, montazh i kujdeshëm i mobilieve në shtëpi të klientëve, shërbim mobilimi të personalizuar, financime për të kënaqur çdo kërkesë.

Sot Grupi Mercatone Uno është i pranishëm thujse në të gjitha Krahinat italiane.

Çdo pikë shitjeje arrihet lehtë dhe shtrihet në sipërfaqe të mëdha. Mercatone Uno është hapur çdo të diel dhe në shumë prej ditëve festive, për t'u përgjigjur kërkesave të të gjithë klientëve.

shqiptari i italisë

l'albanese d'italia

e përmuajshme suplement i
Bota shqiptare
gazeta e shqiptarëve në itali

BOTIM I / EDITORE Edizioni Bota shqiptare srl - (Il mondo albanese)

REDAKSIA / REDAZIONE

Viale Marco Polo 119, 00154 ROMA

Tel 06-57289240 Fax 06-62209543 Cell. 339-3798796

Regjistruar në Regjistrin e Shtypit të Gjykatës së Romës.

BOTA SHQIPTARE É ISCRITTO AL REGISTRO STAMPA DEL TRIBUNALE DI ROMA AL nr. 213/99 del 12/05/1999.

www.botashqiptare.net redaksia@botashqiptare.net

DREJTOR BOTIMI / DIRETTORE EDITORIALE Roland Sejko KRYEREDAKTOR / CAPOREDATTORE Arta Bardhi REDAKTORE / IN REDAZIONE Ketii Biçoku, Albana Temali, Marjola Rukaj

NË BASHKËPJUNIM ME / IN COLLABORAZIONE CON Edizioni Stranieri in Italia

STAMPA: Centro Stampa Quotidiani S.p.A - via dell'Industria 52 - 25030 Erbusco (BS)

Sanatoria: Libër udhëzimesh on-line

vijon nga faqja 3

fiskale të punëdhënësit e të punëmarrësit (kur ky i fundit është klandestin, shënohet numri i pasaportës) dhe të dhënat personale dhe adresa e punëdhënësit.

Për bashkëpunëtorët familjare italiane apo komunitare shnohet kodi "RINT" ndërsa për ato jokomunitare "REXT". Për përpilimin e saktë të modelit mund të shkarkoni këtu edhe udhëzimet, shembujt dhe modelin F24, të vëna në dispozicion nga Agjencia e të Ardhurave.

Është gjithashtu e nevojshme të blihet një pullë-taksë prej 14,62 eurosh, kodi me vija e të cilës do të kërkohet kur të përpilohet kërkesa e legalizimit.

Paraqitja e kërkesës on-line

Punëdhënësi mund të paraqesë kërkesën, vetëm në rrugë telematike, përmes faqeve internet të ministrisë së Brendshme - www.interno.it.

Nga ky web-site do të jetë e

mundur të shkarkohet programi për marrjen e modulit që duhet përpiluar dhe dërguar brenda datës 30 shtator 2009.

Është, natyrisht, e mundur, që kërkesa të përpilohet, të ruhet në kompjuter, të kontrollohet e të nisët më pas, por gjithnjë brenda afatit të paracaktuar.

Në seksionet dedikuar kësaj çështjeje do të jenë në dispozicion edhe udhëzues përdorimi për të ndihmuar të interesuarit në përpilimin e kërkesës.

Pasi nisët moduli, sistemi informatik do të nisë një e-mail konfirmimi në postën elektronike të personit që ka paraqitur kërkesën. Data efektive e paraqitjes së kërkesës do të jetë ajo që do të jetë shkruar në e-mail.

Kuponi i paraqitjes së kërkesës do të gjendet në brendësi të web-site-t në zonën "elenco komande inviate" dhe mund të shtypet pas marrjes së e-mail-it të konfirmimit. Punëdhënësi duhet t'i dorëzojë

një kopje të kuponit punonjësit për të treguar që paraqitja e kërkesës për legalizimin e marrëdhënies së punës është kryer.

Mbështetja e komunave, patronateve, shoqatave dhe privatëve

Edhe pse ministria e Brendshme bën të ditur që përpilimi i moduleve është i thjeshtë, punëdhënësit që nuk dëshirojnë të rrezikojnë mund t'u drejtohen komunave dhe patronateve falas, shoqatave të kategorisë, që në këmbim të përpilimit të praktikës mund t'u kërkojnë regjistrimin në shoqatë, dhe avokatëve apo konsulentëve të punës kundrejt pagesës së një shume.

Ç'ndodh më pas

Nga 1 tetori 2009 Sporteli Unik për Imigracionin do të marrë kërkesat. Pas marrjes së mendimit të Kuesturës mbi motive të mundshme penguese për lëshimin e lejes së qëndrim-

it, punëdhënësi e punonjësi do të thirren për:

Verifikimin e deklaratave të bëra telematikisht në kërkesën për legalizim të marrëdhënies së punës;

Paraqitjen e dokumenteve mbi të ardhurat apo të certifikatave mjekësore;

Verifikimin e derdhjes së shumës prej 500 euro;

Verifikimin e kodit identifikues së pullë-taksës;

Më pas do të procedohet lidhjen e kontratës së qëndrimit me nënshkrimin e një formulari të posaçëm nga punëdhënësi e punonjësi. Punonjësit do t'i dorëzohet modeli 209 që do të paraqesë në një zyrë poste për të kërkuar lëshimin e lejes së qëndrimit.

Pranë Sportelit Unik do të jenë të pranishëm edhe operatorë të INPS-it për t'i dhënë mundësi punëdhënësit të kryejë menjëherë komunikimin e detyrueshëm të punësimit.

Mirëserdhët

në shtëpinë tonë.

Dhomë gjumi
BRUNELLA
849€



Paguaj me këste të leverdishme.
Kërkoje financimin në dyqan.

UNIVERSI I KURSIMIT
www.mercatoneuno.com



NDRYSHIMET PËR MARRJEN E SHTETËSISË

Dekreti mbi sigurinë sjell edhe shtrëngime në marrjen e shtetësisë italiane, të cilave nuk u shpëtojnë as ata që kanë paraqitur kërkesat më parë dhe që presin përgjigjen e Prefekturave

Ligji nr. 94 i 15 korrikut 2009 me "Dispozita në çështjet e sigurisë publike", i njohur ndryshe si paketa e sigurisë, ka sjellë, mes të tjerash, ndryshime thelbësore në normat mbi marrjen e shtetësisë italiane.

Para ardhjes në fuqi të këtij ligji (më 8 gusht 2009), bashkëshorti i huaj i shtetasit italian mund të paraqiste kërkesë për marrjen e shtetësisë për martesë pas gjashtë muajve rezidencë të rregullt në Itali nga data e lidhjes së martesës. Madje, nëse më pas ndodhte ndarja e bashkëshortëve, praktika për njohjen e shtetësisë shkonte përpara, pasi ishte e mjaftueshme - nga çka parashikonte ligji në fuqi - që kushtet të plotësoheshin vetëm në çastin e paraqitjes së kërkesës gjë që u jepte të interesuarve njëfarë "të drejte të fituar".

Me ndryshimet e fundit të ardhura në fuqi më 8 gusht 2009 është zgjatur koha e martesës pas së cilës shtetasi i huaj mund të paraqesë kërkesë për shtetësi për martesë me shtetas italian. Nga gjashtë muaj kalohet në dy vjet rezidencë, por ky afat përgjysohet në rast se çifti bëhet me fëmijë, qofshin këta edhe të adoptuar. Nëse pas paraqitjes së kërkesës në Prefekturë për njohjen e shtetësisë italiane ndodh ndarja apo zgjidhja

e martesës, praktika e shtetësisë hidhet poshtë, pasi normat e reja përcaktojnë - dhe kjo është risia më e rëndësishme - që martesa duhet të jetë e tillë deri në çastin e njohjes së shtetësisë nga Ministria e Brendshme.

Një risi tjetër është edhe fakti që nuk do të mund të vetëcertifikohet më statusi familjar, rezidenca, apo të tjera kushte, por i duhen bashkangjitur kërkesës dokumentacioni i nevojshëm (certifikata të zyrave të Gjendjes civile) që dëshmon këto fakte. Në rast se ky dokumentacion nuk paraqitet, kërkesa nuk do të pranohet (kjo vlen edhe për shtetasit komunitarë). Vetëcertifikimet nuk do të pranohen më qoftë për kërkesat e shtetësisë për martesë qoftë për ato për natyralizim.

Me normën e re parashikohet gjithashtu edhe kontributi prej 200 eurosh për të gjitha kërkesat për shtetësi (për cilindo motiv qofshin) që paraqiten nga 8 gushti 2009 e këtej. Meqë ministria e Brendshme ende nuk ka përcaktuar mënyrat e kryerjes së derdhjes së shumës, kërkesat e shtetësisë po pranohen "me rezervë", që do të thotë se të gjithë ata që po dorëzojnë kërkesat për shtetësi do të mund ta bëjnë normalisht këtë gjë, por do të njoftohen më pas se si e kur të paguajnë 200 eurot.



shqiptari
italise.com
portali i komunitetit shqiptar në Itali

TANI EDHE ONLINE

Po kërkesat e vjetra?

Nuk mund të mendojë se ka shpëtuar kush ka paraqitur kërkesë për shtetësinë para ardhjes në fuqi të ligjit 94/2009. Surpriza aspak të mira ka edhepër ata që janë në pritje të një përgjigjeje nga Prefektura prej shumë kohësh.

Këtë herë, ministria e Brendshme është treguar shumë e shkathët. Madje dy ditë para ardhjes në fuqi të normave të reja ajo u ka lëshuar një qarkore (më datë 6 gusht 2009) të gjitha Prefekturave ku sqaron se si duhet vepruar me praktikën e paraqitura përpara dhe me ato të paraqitura pas datës 8 gusht 2009.

Praktikat e paraqitura prej mëse dy vjetësh (që është edhe afati ligjor për përmbylljen e praktikës së shtetësisë), duhet të vazhdojnë t'i nënshtrohen normave të vjetra, në fuqi kur janë paraqitur këto praktika. Madje në rastin e praktikave të shtetësisë për martesë, ministria sqaron se ato duhet të mbyllën "me dekretin e njohjes së shtetësisë italiane pasi, pas dy vjetëve, bashkëshorti i huaj ka fituar të drejtë të plotë subjektive të shtetësisë dhe kjo nuk mund t'u mohohet më (sipas nenit 6 të ligjit nr. 91/1992)".

Ndërsa për praktikën e paraqitura gjatë dy vjetëve të fundit para ardhjes në fuqi të normave të reja (nga 8 gusht 2007 deri më 7 gusht 2009) duhet të aplikohen normat e reja. Në rastin e shtetësisë për martesë, duhet të verifikohet nëse në datën e ardhjes në fuqi të ligjit kërkesa përmbush kushtin e dy vjetëve rezidencë në Itali pas datës së martesës si dhe, më pas, fakti që martesa është ende e vlefshme në çastin e njohjes së shtetësisë (me anë të një certifikate të re martesë).

Për më tepër kërkesit e shtetësisë për martesë që kanë paraqitur kërkesën dy vjetët e fundit para ardhjes në fuqi të normave të reja duhet të paraqesin edhe të gjithë dokumentacionin në origjinal që kanë vetëcertifikuar në çastin e paraqitjes së kërkesës (certifikatë rezidence, të çështjeve penale hapura dhe të kartotekës së gjykatës etj.).

Gjithashtu ministria ka nxjerrë edhe modularët e rinj që duhen përdorur këtej e tutje për paraqitjen e kërkesave të shtetësisë. Janë të ngjashëm me të mëparshmit, por mes dokumenteve që i duhen bashkëngjitur kërkesës numërohen të gjitha ato që më parë mund edhe të vetëcertifikoheshin si dhe dëshmia e derdhjes së 200 eurove. Këta formularë mund t'i gjeni edhe në faqet internet të www.shqiptariitalise.com.

Avv. Mascia Salvatore

Më në fund, nga 15 gushti 2009 marrëveshja dy-palëshe për konvertimin e patentave shqiptare në Itali është realitet. Sipas sqarimit të nëpunëses Celentano të departamentit të Motorizimit Civil të Ministrisë së Infrastruktura dhe Transporte, "konvertimi i patentave ka filluar nga data 17 gusht 2009 pasi 15 e 16 gusht ishin ditë festive. Megjithatë e drejta e konvertimit u njihet edhe atyre që kishin një patentë shqiptare që u skadoi pikërisht në njërin prej këtyre dy ditëve".

Marrëveshja mes dy shteteve për njohjen reciproke dhe konvertimin e patentave për dhënien e makinës, është nënshkruar tetorin e vitit të shkuar nga ministri i jashtëm Italian Franco Frattini, në kuadrin e bashkëpunimit në sektorin e transporteve të nisur nga qeveritë e të dy vendeve, në prani të kryeministrit shqiptar Sali Berisha, dhe ministrit të jashtëm Lulzim Basha. Por vetëm tani me ratifikimin e plotë të kësaj marrëveshjeje ajo hyn në fuqi. Ashu siç parashikohet edhe në tekstin e marrëveshjes, në nenin 10, ajo do të jetë e vlefshme për pesë vjet.

Për të konvertuar një patentë shqiptare, para së gjithash, duhet treguar që ajo është marrë në Shqipëri para vendosjes së rezidencës në Itali dhe se kërkuesi i konvertimit të patentës ka një dokument qëndrimi në Itali, leje apo kartë qëndrimi, të vlefshëm.

Nëse titullari i një patente shqiptare, vjen e merr rezidencën në Itali, ai konverton patentën e tij pa qenë nevoja të japë provimet e teorisë dhe të praktikës, me përjashtimin e rasteve të mëposhtme të parashikuara në nenin 4 të marrëveshjes: "nëse titullari i patentës shqiptare ka rezidencën në Itali prej mëse 4 vjetësh, e konverton atë pasi u nënshtrohet provimeve të rishikimit të lejes së drejtimit, por vetëm në rast kur është vërtetuar që nuk ka drejtuar automjete për një periudhë trevjeçare".

Një tjetër kufizim i përcaktuar në marrëveshje ka të bëjë lidhet me modelin e patentës shqiptare: sipas marrëveshjes "do të konvertohen patentat në formatin card të lëshuara nga 1 korriku 2005"; ndërsa "patentat në karton, në fuqi prej 1 nëntorit 1999, mund konvertohen në Itali vetëm vitin e parë nga data e ardhjes në fuqi të marrëveshjes, pra nga 15 gusht 2009 deri më 14 gusht 2010". Gjithashtu marrëveshja parashikon që për konvertimin e këtyre patentave pala italiane do të kërkojë edhe "një certifikatë vërtetësie e vlefshmërie të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit".

Marrëveshja është e mirëpritur nga shumë e shumë shqiptarë në

HYN NË FUQI MARRËVESHJA MBI KONVERTIMIN

PATENTAT SHQIPTARE ME NË FUND NJIHEN EDHE NË ITALI

Sipas Ministrisë së Infrastruktura dhe Transporte, konvertimi i patentave shqiptare është njësoj si ai i patentave të vendeve të tjera jo anëtare të BE-së që kanë nënshkruar marrëveshje dypalëshe me Italinë, ashtu si Shqipëria. I vetmi shënim për Shqipërinë është që marrëveshja është në fuqi për pesë vjet, duke filluar nga 15 gushti 2009



Në të djathtë certifikata e vërtetësisë dhe e vlefshmërisë që lëshojnë organet shqiptare (të përpiluar në gjuhën italiane), në modelin e parashikuar nga marrëveshja

Procedura dhe dokumentet e nevojshme për konvertimin

Kërkesa e konvertimit duhet bërë pranë një zyre provinciale të motorizimit civil duke paraqitur këto dokumente:

- Kërkesa në modularin TT 2112 (që jepet në sportel) e përpiluar dhe e nënshkruar;
- Dëshmia e derdhjes së 29,24 eurove në llogarinë rrjedhëse postare 4028;
- Dëshmia e derdhjes së 9,00 eurove në llogarinë postare 9001. Buletinet e llogarive rrjedhëse të gatshme mund të gjenden në zyrat e postës ose në Zyrat Provinciale të Departamentit të Transportit tokësor. Nuk mund të përdoren buletinet të tjera përveç këtyre të gatshme;
- Patenta shqiptare në origjinal;
- 2 fotografi format tesera;
- Certifikata mjekësore me pullë-taksë me fotografi (bëhet në ASL dhe nga mjekë të autorizuar) e gjashtë muajve të fundit;
- Fotokopja e kodit fiskal;
- Fotokopja e lejes apo e kartës së qëndrimit e paskaduar, ose kuponit i përtëritjes;
- Një dokument me pullë-taksë me përkthimin e të dhënave të patentës shqiptare. Përkthimi me tekstin shqip duhet të certifikohet nga përfaqësia diplomatike (konsullatat) shqiptare në Itali. Kjo certifikatë duhet të konvalidohet më pas në Prefekturë;
- Për konvertimin e patentave në formatin e vjetër, në karton, të ardhura në fuqi më 1 nëntor 1999, kërkohet një certifikatë vërtetësie e vlefshmërie të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit e Shqipërisë (që do të lëshohet në modelin lart djathtas, e parashikuar në marrëveshje).

REPUBBLICA DI ALBANIA MINISTERO DEI LAVORI PUBBLICI, TRASPORTI TELECOMUNICAZIONI DIREZIONE GENERALE SERVIZI TRASPORTI STRADALI	
Certificato di Validità e Autenticità della patente di guida n. _____	
1) Dati anagrafici del titolare della patente: Nome _____ Cognome _____ Data di nascita _____ Luogo di nascita (con indicazione del comune e della nazione) _____	
2) Traduzione della patente di guida (allegata fotocopia fronte-retro) Traduzione fronte patente di guida _____ Traduzione retro patente di guida _____	
3) Eventuali prescrizioni: (ad es. obbligo lenti, protesi acustiche, ecc.): _____	
4) La patente è autentica e in corso di validità. scade il _____	
5) Data del primo conseguimento: _____	
6) La patente deriva/non deriva da conversione di altra patente estera rilasciata da _____	
Data e luogo _____	Timbro e firma del funzionario _____
(*) barrare il caso che non ricorre	

Itali, por me thënë të vërtetën, fjalët e ministrit shqiptar të Transportit, Olldashit, në konferencën e shtypit të datës 5 gusht 2009, janë mëse të tepruara. Ai pohon se "nga kjo marrëveshje përfitojnë 500 mijë shqiptarë që janë rezidentë të përhershëm në Itali", por faktet tregojnë se marrëveshja mund të jetë e dobishme as për një të tretën e shqiptarëve për të cilët flet ministri. Për dy arsye të thjeshta: rezidentët shqiptarë në Itali, sipas të dhënave më të fundit të ISTAT-it, më 1 janar 2009 janë 441.073 vetë dhe sipas një statistike "të vjetruar" të Ministrisë italiane të Transporte, më 31 mars 2006, plot 210 mijë shqiptarë kishin patentën italiane. Kështu që mund të themi pa frikë që po të heqim numrin e të miturve, dhe të mbajmë parasysh që edhe gjatë këtyre tre vjetëve të fundit me mijëra shqiptarë të tjerë kanë marrë patentën italiane, del se numri i atyre që mund të përfitojnë nga marrëveshja zvogëlohet shumë.

Sidoqoftë kjo marrëveshje mbetet shumë e rëndësishme për shqiptarët që do të vijnë në Itali gjatë viteve të ardhshme.

Keti Biçoku

Albana Temali

Shpesherë janë përshlytjet që të lëshikimi i një realizimi artistik, qoftë ky në pikturë, skulpturë, fotografi etj. Ato që të shtynë të njohësh autorin. Më ndodh kjo shpesherë sidomos kur vizitoj ekspozita e më pas kërkoj të kompletoj njohjen me informacion që në atë moment është vështirë të sigurohet. Pas çdo krijimi është njeriu me historinë e tij unike, me përjetimet e tij, me botëkuptimin e tij e një njohje me të është një element më shumë në kuptimin më të saktë të vetë krijimit. Kjo tendencë pothuaj më është kthyer në zakon, e çdoherë përballim me surpriza edhe atëherë kur jam e bindur që kisha gjetur gjithçka. Mbetet gjithnjë diçka e pathënë e pashkruar. Jeta e të gjithëve është një transformim i vazhdueshëm, aq me tepër jeta e një artisti që ndjek një rrugë me një drejtim të vetëm: kërkim i formave të reja të shprehjes artistike. Intervista njihet si mjet mjaft me vlerë për të njohur personazhet, por për vetë natyrën e këtij procesi: transformues çdo detaj i kapur dhe i përshkruar në një intervistë mund të mos konfirmohet në një të ardhme. E uroj të jetë kështu, mbase është denoncim i jetës së procesit, i efektit të tij mbi jetën e artistit.

E bëra këtë hyrje mbasi artisti që mora në konsideratë për këtë intervistë është i ri në moshë, eksperiencia e tij po ashtu akoma më e re, por pikërisht për këto dy arsye bëhet interesante dhe ngjall kureshti. Personazhi quhet Saimir Shara dhe ka lindur në Shkodër në vitin 1981. Në qytetin e lindjes ka përfunduar edhe studimet në shkollën e mesme në 2000-shin, e po këtë vit është transferuar në Itali ku dhe jeton e punon. Saimiri jeton mes Aostës e Torinos ku dhe aktualisht punon si fotograf për shumë institute valdostane dhe të krahinës. U njoha me fotografinë e tij rastësisht. Ishte foto-portreti i një miku të përbashkët, bashkëmohatar i tij. Ishte foto e realizuar mjaft mirë, jo vetëm nga ana artistike në dritë-hijet e saj, por kompozimi përcillte karakterin e personazhit, të cilin e njihja shumë mire. Nuk dëshiroja të isha viktime e një gjykimi arbitrar të ndikuar nga elemente që në njëfarë mënyre më përfshinin nga ana shpirtërore, por gjithsesi e konsiderova autorin e fotografisë një artist me



SAIMIR SHARA "Fotografia është muzika ime"

Fotografi 28 vjeçar shkodran ka në portofolin e vet fotografik me qindra personazhe, të panjohur e shumë të njohur.



talent. Kërkova të shikoj realizime të tjera dhe aty intuïta ime gjeti pohimin. Saimir Shara, ky fotograf i ri kishte në albumin e tij portrete të aktorëve italianë të mirënjohur; kompozime mjaft të realizuara me tematikë të larmishme ku prekeshin me art tema shumë të forta sociale.

Natyrisht, kërkova të mësoj më shumë nga vetë Saimiri. Po ju sjell në këtë intervistë bashkë me fjalët e tij edhe disa nga fotografitë e realizuara që më saktë pasqyrojnë aktivitetin e këtij artisti shqiptar në Itali.

INTERVISTA

Takimi juaj me fotografinë?

Fotografia krijoi një lidhje direkte dhe të pavetëdijshme me mua. Shpesh mendoj se ishte një rastësi.

Të aplikosh në një fushë arti kërkon para së gjithash një bazë teorike. C'rrugë ka ndjekur formimi juaj e Kush është "guida" juaj?

Pas disa kurseve fotografie në Itali, vendimtar për mua ishte takimi me fotografin torinez Paolo Ranzani. Unë kisha nisur një e-mail pa shpresuar që të merrja një përgjigje. Takimi i parë me të më la të kuptoj që kontaktin e kishte pranuar nga fotoja që i kisha dërguar unë. Menjëherë kuptova që isha brenda një studioje ku mund të gjeja vetveten.

Ç'është për ju sot fotografia?

Të flasësh për fotografinë sot nuk është e lehtë: por po provoj. Fotografia sot është rinovuar komplet, pra ka lindur një fotografi e re. Dhe unë jam shumë optimist për këtë. Me lindjen e fotografisë digjitale mundësia e një fotografi është shumë më e madhe se sa ishte me fotografinë analogjike. Nuk besoj se duhet të "trembë" besimi që fotografia digjitale e dobëson punën e një fotografi. Unë besoj se do të mbesin ato fotografë që janë të zotë dhe që dallojnë mes të tjerëve.

vijon në faqen 10

Vetëm **15 cent.€/min**
për të telefonuar në **Shqipëri.**
Atdheu yt nuk ka qenë kurrë
kaq afër.



Aktivizo menjëherë No Distance
dhe telefono në Shqipëri me 15 cent.€/min.



 Store | www.tre.it

199 100 700

SHKREHJA E PËRGJIGJES 16 CENT.€, TARIFIMI VETËM MBI SEKONDAT EFEKTIVE TË BISEDËS. OPSIONI NO DISTANCE AKTIVIZOHET ME 0€ PËR 30 DITË E PARA NËSE NËNSHKRUHET GJATË FAZËS SË AKTIVIZIMIT TË NJË SKEDË RIMBUSHËSE 3. NË SKADIM PARASHIKOHET PËRTËRITJA AUTOMATIKE PËR 30 DITË KUNDREJT KOSTOS SË 5€. OPSIONI I VLEFSHËM VETËM NË ITALI NËN MBULIMIN KOMBËTAR TË 3, PËR PERIUdhËN E AKTIVIZIMIT, DHE JO I PAJTUESHËM ME PLANIN RIMBUSHËS SUPER O MONDO, ME OPSIONIN INTERNATIONAL 3 DHE ME PLANET E ABONIMIT. PËR INFORMACIONE MBI MBULIMIN, KUSHTET DHE KOSTOT WWW.TRE.IT OSE 3 STORE.

Cili është modeli i fotografit që ndiqni?

Nuk di ta përcaktoj tani. Por mund të tregoj se cila është rruga që po ndjek sot: kërkoj më shumë personazhet dhe realizoj portretet e muzikantëve dhe artistëve të kinemasë apo teatrit.

Ndër portretet tuaja edhe aktori tashmë i mirënjohur Alessandro Gassman, James Galway. Një privilegj ky për një artist të ri shqiptar apo jo? Diçka nga kjo eksperiencë...

Alessandro Gassman erdhi në Aosta për shfaqjen me titull "Parola ai Giurati" për t'i thënë "jo" ligjit me vdekje. Shfaqja u dha në Teatrin "Giacosa" të Aostës dhe unë isha i ngarkuar të bëja një fotografi për seksionin e kulturës së Aostës. Kështu takimi me të nuk ishte një rastësi, por duhej një foto e tij. Që në çastin që iu afrova e kuptova që është tip praktik dhe jashtë skenës. Menjëherë u tregua i gatshëm të pozonte. Kur e mori vesh që jam shqiptar më "bombardoi" me pyetje (besoj se s'kishte takuar nga afër asnjëherë një shqiptar. Këtë nuk ma konfirmoi, por arrita ta kuptoj nga interesi i madh me të cilin më pyeste për vendin). I interesonte të dinte mbi kinematografinë shqiptare, por dhe perspektivën e Shqipërisë në Europë. Gjatë gjithë kohës që e fotografoja më pyeste mbi Shqipërinë. Besoj se kam arritur të "kap" karakterin e tij në foto-portretin e dedikuar.

Ndërsa James Galway personazh simpaticissimo!

Në momentin që shfaqja mbaroi takohem direkt me Galway në dhomën e tij. Ai u tregua i përzemërt që në momentin e parë, duke më kërkuar të dinte se i çfarë marke ishte aparati dhe nëse mundej të bënte foto dhe ai vetë: siç dukej ishte i pasionuar pas fotografisë. Këto janë disa nga episodet. Po të tilla kam në çdo rast që fotografoj një personazh.

Portreti zë një vend të veçantë në krijimtarinë tuaj e kryesisht aplikimi i bardh e zi. E ndieni që këtu shprehni më mirë? Kjo përzgjedhje është e sugjeruar apo e rastësishme?

Në momentin kur fotografoj kuptoj direkt ngjyrat që duhet të kenë fotot. Nuk kam një preferencë mes fotografisë bardh e zi dhe asaj me ngjyra.

Cila është tematika e punimeve e nëse keni preferenca e pse?

Tematikat e ftove të mia janë shpesh sociale, ashtu si jam munduar edhe me ciklin "Velipoje", por anoj nga portretet e shpesh mendoj, për faktin që jam i huaj në Itali është më e lehtë të fotografoj personazhet (duket sikur lidhjet me to janë më natyrale).



Cilët janë personazhet e kulturës shqiptare që keni fotogra-

SAIMIR SHARA

vijon nga faqja 8

”

Alessandro Gasman erdhi në Aosta për shfaqjen me titull "La Parola ai Giurati" Gjatë gjithë momentit që e fotografoja më pyeste mbi Shqipërinë. Besoj se kam arritur të "kap" karakterin e tij në foto-portretin e dedikuar.



ALESSANDRO GASSMAN

fuar e cilët do të dëshironit të fotografoj?

Fotografitë e realizuara në Shqipëri nuk janë të shumta. Kam fotografuar Cesk Jubanin, shkrimtarët e rinj Erion Temali, Astrit Cani, por kam një listë të gjatë me artistët si: Ndrim Xhepa, Mirush Kabashi, Koço Devole... duke mos harruar dhe shkrimtarët e mirënjohur si Shpëtim Kelmendi, Ridvan Dibra por dhe Kadarenë etj. Ndër personazhet, do të dëshiroja të fotografoja Ramiz Alinë, dhe pse arkivi fotografik i tij është shumë gjigand, do doja t'i shtoja dhe një timen.

Njohjet me fotografë të tjerë me siguri kanë nxitur kureshtjen për Shqipërinë, vendlindjen tuaj. Sa e njohin Shqipërinë e fotografinë shqiptare?

Po kanë nxitur kureshtjen për Shqipërinë, por kjo shuhet shumë shpejt... sapo e kuptojnë që nuk kemi treg për foton. Në përgjithësi fotografia italiane transportohet

jashtë Italisë nëpërmjet agjencive të publicitetit. Interesi mbi Shqipërinë është akoma i dobët (unë flas gjithmonë mbi bazën e fotografëve italianë dhe të huaj që kam njohur).

Përveç fotografisë keni ndonjë pasion tjetër në fushën e kulturës dhe të arteve?

Muzika klasike! Dhe njoh shumë muzikantë shqiptarë që ndodhen në Itali.

Cili është projekti i ardhshëm i ekspozimit? Me çfarë tematike?

Kam një ide-projekt të diskutuar me ministrin e kulturës pranë Ambasadës shqiptare në Romë, poetin e mirënjohur Visar Zhiti për një ekspozim nga cikli "Velipoja the beach of north Albania" në ambientet e Ambasadës, e shpresoj të mundësohet sa më parë. Po kështu projekti me ekspozitën mbi muzikantët e Valle d'Aostës, për të cilin jam në pritje të përgjigjes nga rajoni.

Albana Temali



Armillotta sjell historinë e parë të futbollit shqiptar

Botohet libri i parë në gjuhë të huaj për historinë e futbollit shqiptar. Një vepër unike e Doktorit të mirënjohur të Shkencave Politike në Universitetin e Pisa-s


Krejt papritmas, të shtunën që shkoi, kam marrë librin e Dr. Giovanni Armillotta-s, "Almanacco della Serie B (1930/2008-09) e del calcio Albanese" ("Almanaku i kategorisë së dytë [1930/2008-09] dhe i futbollit shqiptar").

Është absolutisht libri i parë historik që i kushtohet futbollit shqiptar të kampionateve të kategorisë së dytë. Dhe nga ana tjetër, është libri i parë historik për futbollin shqiptar botuar në gjuhë të huaj prej një autori të huaj. Mû për këto, botimi i këtij libri përbën një ngjarje të rëndësishme në historinë e studimeve sportive, të futbollit dhe të krejt publicistikës sportive shqiptare.

Kemi pasur edhe raste të tjera për të botuar dhe folur për studimet e gjithanshme të Dr. Armillotta-s, edhe në faqet e kësaj gazete. Rreth veprimtarisë, jetës dhe lidhjes së hershme të tij me Shqipërinë, historinë e saj në tanësi, sportin shqiptar, esetë e tij studimore për politikën shqiptare ndër vite dhe epoka, nuk do të zgjatem, sepse botimi këtu bashkangjitur i paraqitjes që shoqëron librin, shkruar prej gazetarit dhe studiuesit të mirënjohur, Armand Plaka, shterron më së miri temën.

Në këte shënim të shkurtër, si mik i vjetër, prej gati 30 vjetësh me Armillotta-n, desha vetëm të spikas edhe një herë veprimtarinë dhe punën e tij gazetareske, studimore e shkencore rreth Shqipërisë, çka siç thotë me të drejtë Plaka, e bën Armillotta-n një albanolog të vërtetë të kohëve moderne.

Sot njerëzit e sportit, të fut-



Giovanni Armillotta, Almanaku i kategorisë së dytë (1930/2008-09) dhe i futbollit shqiptar - Almanacco della Serie B (1930/2008-09) e del calcio albanese, Aracne, Roma 2009, ISBN 978-88-548-2585-7, pp. 188, € 13,00 (info@aracneeditrice.it)

bollit shqiptar, të vetë historisë kombëtare madje, kur kujton se pjesë e saj janë edhe sportet dhe futbollit, do të mund të kenë ndër duar një vepër unike (të vetme), e cila do t'i bëjë të mendojnë gjatë. E vërteta është se, përveç të tjerave, është fjala për një histori statistikore të një pjese të rëndësishme të ecurisë së futbollit shqiptar, në të cilën ndër gati 80 vjet janë "ngatërruar" për mirë të gjitha skuadrat shqiptare, me përjashtim të Dinamos dhe SK Tiranës - të vetmet që nuk e kanë shkelur tokën "misterioze" të Kategorisë së Dytë. Dhe nuk janë pak, por dhjetëra e dhjetëra skuadra e klube, që i përkasin të gjitha qyteteve, krahinave, rajoneve, rretheve, prefekturave të Shqipërisë: qytete, qyteza, fshatra, fabrika, uzina, ndërmarrje, kooperativa, NB.

Libri i Dr. Armillotta-s të habit me gjerësinë e shtrirjes së tij historike, me emrat e pafund të

skuadrave dhe futbollistëve të paraqitur kronologjikisht qysh nga 1930 e deri më 2009 dhe çka është më e rëndësishme, për herë të parë me të gjitha tabelat renditëse të të gjithë Kampionateve të Kategorisë së Dytë.

Shkencor, statistikor, historik, e pse jo, deri diku edhe gjeopolitik, siç është fusha e parapëlqyer studimore e Dr. Armillotta-s, gazetari, historiani, futbollisti, trajneri, zyrtari i futbollit, vetë FSHF do të kuptojë se sa e lodhshme dhe skrupuloze ka qenë kjo punë studimore e albanologut në fjalë. E, madje, edhe fisnike, kur mendon se për herë të parë shfaqet një vepër futbollit që përjetëson skuadra e futbollistëve të harruar në Shqipëri.

Me mënyrën e kompozimit të tij, libri arrin të dalë edhe përtej "Serie B" të Shqipërisë, duke prekur edhe pjesë të tjera të historisë së futbollit shqiptar. E pashlyeshme paraqitja statistikore e të gjithë veprimtarive të tjera, "të panjohura" kombëtare të futbollit shqiptar: të gjithë turnetë e Spartakiadave kombëtare, të gjitha kupat e gazetave, revistave e të tjera, që kanë ndikuar jo pak në ecurinë e dhe zhvillimin e futbollit shqiptar.

Dhe këtë nuk e bëme ne, por një huaj, një mik i madh nga Italia, një profesor, një studiues, i cili sapo i jep kështu jo vetëm Shqipërisë, por Evropës së futbollit, një histori të futbollit shqiptar në një nga gjuhët më të vjetra të saj: në italisht.

I botuar në një cilësi të lartë grafike si pjesë e kolanës së editorit "Saggistica ARACNE" në Romë, libri i Dr. Armillotta-s, është një lloj margaritari i vogël që do të mbetet jetëgjatë në ndriçimin e tij në nxitje të zhvillimit më tej të futbollit shqiptar.

Besnik Dizdari

Libri shqip në Itali

Italia tashmë prej shumë vitesh është bërë një vend ku prania e emigrantëve ka qenë gjithnjë e në rritje. Shqiptarët janë sot një nga komunitetet jo vetëm më të mëdhenj por edhe nga më të integruarit, ashtu si na thonë statistikat e fundit. Shumë shpesh legjislacioni që rregullon jetën e të huajve në Itali nuk është shumë zemërgjerë dhe lëshues, sidomos në periudhën e tanishme.

Ka shumë raste ama projektesh dhe iniciativash që janë për tu lavdëruar dhe që në shumicën e rasteve kanë si promotorë entet lokal, komunitat, provincat, shoqatat e ndryshme të huaja dhe italiane që merren me të huajt. Një sektor pak i njohur dhe zakonisht i nënvlefësuar është ai i sektorit të kulturës, dhe në veçanti të librit shqip në territorin italian.

Në shumë biblioteka italiane, kryesisht në ato komunale, ka sektorë të caktuar me libra në gjuhë të huaj, ndër të cilat edhe shqipja. Në shumicën e rasteve këto biblioteka dhe bashkitë që i administrojnë e bëjnë këtë për të favorizuar ruajtjen e gjuhës amtare dhe për të ofruar emigrantit që jeton në Itali një mundësi që të lexojë libra cilësor, falas dhe në gjuhën e tij.

Në shumë raste, ka qenë aktivizmi i disa shoqatave shqiptare që ka shtyrë bibliotekat të pajisen me libra. Raste të tilla janë ai i shoqatës Vatra në Torino, Mërgimtari në Cuneo dhe të tjerë akoma. Teorikisht mundësia për ti kërkuar libra në gjuhën amtare bibliotekës ku çdo shqiptar banon i përket të gjithëve dhe mjafton t'i shprehni dëshirën bibliotekës atje ku banoni.

Ruajtja e gjuhës shqipe është e rëndësishme për të gjithë ata që banojnë jashtë Shqipërisë, në veçanti ky fenomen mer një rëndësi akoma më të veçantë për ata u përket fëmijëve. Kjo kategori është më e ekspozuar kundrejt rrezikut të humbjes së gjuhës, nëse nuk ka veprime konkrete për të parandaluar këtë fenomen.

Aktivitetet në fjalë janë gjithnjë në zhvillim konstant dhe nuk ndalen vetëm te libri. Kanë të bëjnë me takime me autorë të ndryshëm, lexime të veçanta në biblioteka dhe ambiente të tjera, takime me shoqata dhe organizata kulturore që kanë si objektiv të tyrin zgjerimin e horizontit kulturor të individëve.

Duke nisur nga ky numër kjo rubrikë do t'i dedikohet botës së librit shqip, ku herë pas here do ketë recensione librash, përshtypje të lexuesve, kritikëve letrarë mbi një vepër, intervista me autorë shqiptarë që shkruajnë në Shqipëri si dhe ata që shkruajnë në Itali. Informacionet do kenë të bëjnë dhe me eksperiencën domethënëse në Itali ku kultivohet gjuha dhe kultura shqiptare.

librialbanesi.it



PROMOZIONE E DISTRIBUZIONE DEL LIBRO ALBANESE IN ITALIA

www.librialbanesi.it

Për çfarëdolloj informacioni, kërkese, opinioni dhe bashkëpunimi që ka të bëjë me librin shqip, mos hezitoni të na kontaktoni

info@librialbanesi.it Tel: +39 3890939930 Fax: 0575 1949538

POWERCARD

Leverdis sepse flet më gjatë!

MINUTA SHQIPËRI € 10	NGA NUMËR FIKS	NGA NUMËR PUBLIK	NGA CELULAR ITALIE	NGA CELULAR WIND	NGA NUMËR GJEOGRAFIK
SHQIPËRI	180	64	38	70	200
SHQIPËRI, TIRANË	300	82	44	86	320
SHQIPËRI, CELULARË VODAFONE	54	36	26	36	60

Zbulo
leverdinë Powercard
për vendin tënd në
www.powercard.it
ose pranë pikave Sisal

SINERGIA ADV.

tag
KEEP IN TOUCH

Tarifa në fuqi nga 01/09/09 për kartat e
parapaguara prej 10 eurosh, lista tarifore
Powercard ShBA&Europa e TAG International.
Tarifat shpallen në faqet internet www.powercard.it

Informacione në 06 96595959

**POWERCARD ËSHTË NË SHITJE
NË TË GJITHA PIKAT SISAL.**



Shqipëria zyrtarisht nuk merr pjesë, por është e pranishme në Biennale d'Arte di Venezia nëpërmjet projektit anësor Krossing, me artistët Venera Kastrati, Robert Aliaj Dragot, Artan Shabani, Eliza Hoxha. Dhe Klodian Deda. Ai është ndoshta më i riu ndër shqiptarët e Venecias, dhe bën pjesë në brezin më të ri të artistëve konceptualë shqiptarë, të formuar plotësisht jashtë Shqipërisë.



Rastësitë fatlume të

Klodian Deda është një nga emrat e shqiptarëve që janë duke ekspozuar në Biennalen e sivjetshme të Venecias. Ai është ndoshta më i riu ndër shqiptarët e Venecias, dhe bën pjesë në brezin më të ri të artistëve konceptualë shqiptarë, të formuar plotësisht jashtë Shqipërisë. I lindur në Pukë në 1981, Deda ka zgjedhur Italinë për të marrë atë që Shqipëria nuk arrin t'i ofrojë as brezit të tij aktualisht, prurjen e artit bashkëkohor dhe daljen nga klasicizmi akademik që ende vazhdon të mbizotërojë në ambientet artistike në Shqipëri. Por rrugëti-

mi i tij në botën e artit ka filluar me mësimet e skulpturës në Shqipëri, kurse pikturës i është konvertuar gjatë viteve të fundit ndërsa është duke studiuar në Akademinë prestigjioze të Brerës. Por ekspozitave artistit i ri shqiptar shfaqet me një tjetër përmasë, përtej pikturës e përtej skulpturës klasike, nëpërmjet artit konceptual bashkëkohor që përcjell mesazhe të spikatura plot me simbolizëm e me ironi në ndërthurje e materialeve dhe objekteve ekzistuese që tronditin në kombinime të gjetura, e të pamendueshme sendesh që

KLODIAN DEDËS

përndryshe nuk do të gjendeshin bashkë. Janë të shumta ekspozitat e rëndësishme ku ai ka marrë pjesë, ndërsa aktualisht emri i tij radhitet ndër pjesëmarrësit e biennales së Venecias, një eveniment artistik madhor ky që kushdo ndër artistët e nivelit të tij do të synonte.


Di të jetë i larmishëm e i paparashikueshëm artisti shqiptar. Spikasin ndër punët e tij instalacione që ngjasojnë të frymëzuara nga një pop-art i vonë me sfumatura politike, si një vepër ku disa bluza shfaqen të

RASTËSITË FATLUME.TË KLODIAN DEDES

vijon nga faqja 13


nderura me kokë poshtë në disa korniza. Apo një portë e tejdukshme, me skelet prej hekuri të formuar nga kolazhe trekëndëshash ngjyrë blu të errët, duke prodhuar një derë që nuk kryen plotësisht funksionet përmbyllëse të një dere, por që i ngjason konceptit të derës dhe trondit me çudinë e saj blu, trekëndore, dhe boshësisë së skeletit që duhet të përmante sipërfaqen izoluese. Akoma më ndryshe janë disa nga veprat e tij që kanë në qendër karriget, karrige, me ngjyra, si të nxjerra nga dhoma e ndenjjes së një shtëpie modeste, e të ngjyrosura me ngjyrat bazë sipas kuptimit që vetë autori ka dashur tu veshë elementeve përbërëse të punëve të tij. Kanë qenë pikërisht karriget protagoniste të një ekspozite të zhvilluar në Shqipëri, në kështjellën e Lëkursit në Sarandë. Karriget janë parë të kacavirren në portën e kështjellës së Lëkursit. Ndërsa në një tjetër vepër të titulluar Family, karriget shtëpiake janë të mbivendosura mbi sedilet e një makine, me një kombinim të paimagjueshëm të këtyre dy objekteve të të njëjtit funksioni. Po aq sugjestionuese është edhe një skulpturë leckash, që si një stivë e çrregullt rrobash ngrihet e zhvillohet nga dyshemeja në formë pikëpyetjeje.

Ashtu si edhe gjithë shqiptarët e tjerë, punët e të cilëve janë aktualisht të ekspozuara në Venecia, edhe për Dedën arti është një veprimtari individuale, e sponsorizuar me vështirësitë dhe mundësitë e veta për hir të artit dhe asgjë përtej kësaj. Por realisht këta artistë edhe pse me iniciativën e tyre, dhe me mjetet e veta, janë paraqitur në Biennalen e Venecias, që është një prej takimeve më të



rëndësishme e më prestigjioze të kësaj natyre në nivel botëror, duke shpënë atje emrin e Shqipërisë, e madje duke u konsideruar si përfaqësues të Shqipërisë. Ndërsa Shqipëria në këtë rast, i bie të jetë një përfituese free-rider prestigjioze dhe emri, pa pasur investuar absolutisht asgjë. Ndihet zhgënjim dhe pothuaj shpotitje ndaj Shqipërisë së nderuar qyl, ndërsa artistët flasin për marrëdhëniet e tyre me vendin prej nga vijnë dhe të cilin duan apo nuk duan ata përfundojnë të përfaqësojnë nëpër takime të tilla ndërkombëtare.

ma.ru.



Tre punë të autorit 25 vjeçar:
Nga lart: Ho fame, Rroba, dhe
The Family

Ndihet zhgënjim dhe pothuaj shpotitje ndaj Shqipërisë së nderuar qyl, ndërsa artistët flasin për marrëdhëniet e tyre me vendin prej nga vijnë dhe të cilin duan apo nuk duan ata përfundojnë të përfaqësojnë nëpër takime të tilla ndërkombëtare.

INTERVISTA

nga Marjola Rukaj

Shqiptari i Italisë: Si ndodhi që u transferove pikërisht në Itali? E pastaj, pse Milanon?

Klodian Deda: Ndodhi krejt rastësisht. Një ditë po flisja me një shokun tim që studion këtu në Bicoca. Dhe po i tregoja disa nga vizatimet e mia. Ai pasi i pa të gjitha hapi sytë nga habia, dhe më tha: Ti duhet të frekuentosh një akademi... nuk duhet të rrih kështu e ta lësh veten pas dore. Kështu nisi gjithçka, dhe unë fillova ta merrja seriozisht atë që më tha ai. Pas takimit tonë, bëra një kërkim në internet ku informacione të ndryshme për akademitë e arteve. Atëherë vendosa të vija në Milano, konkretisht në Akademinë e Brerës të cilën të them të drejtën në atë kohë nuk e njihja. Pra ndodhi kështu, që më shumë një rastësi fatlume. Kjo ndodhi katër vite më parë dhe prej asaj kohe, vazhdoj të studioj e të jetoj në Milano, duke frekuentuar akademinë e Brerës. Natyrisht nuk ishte një rastësi e lehtë, dhe e lumtur, si e rënë nga qielli, mu desh të përballesha me vështirësi të ndryshme për të hyrë në akademi. Për shembull, mjafton të përmend faktin se duke qenë që nuk kam bërë një lice artistik, vetëkuptohet që nuk isha shumë i përgatitur në pikturë. Megjithatë kjo nuk më pengoi të bëja një kërkesë për të hyrë në akademinë e Brerës. Por për shkak të papërgatitjes sime që thashë më parë, për fat të keq nuk arrita ta kaloja provimin e pikturës. Por ndodhi për fatin tim të mirë, që aty rastisi një profesor, i cili ishte aty kur unë mora rezultatin negativ, dhe më pa shumë të dëshpëruar. Ai më ftoi të ndiqja një kurs pikturë me klasën e tij, për një vit. Dhe natyrisht unë nuk mund të refuzoja, sepse nuk kisha tjetër zgjedhje. Për pasojë, veprova siç më tha ai. Kalova rreth gjashtë muaj në klasën e pikturës dhe vitin tjetër pastaj më pranuan në akademi pa vështirësi këtë herë.

Dhe pastaj erdhën njëra pas tjetres ekspozitat në aktivitete të rëndësishme në Shqipëri, e



më së fundi edhe pjesëmarrja në biennalen e Venecias së sivjetshme...

Po, edhe për këto duhet të them se janë gjëra që kanë rrjedhur disi në vazhden e rastësive fatlume. Thuhet shpesh herë se për disa gjëra duhet të ndodhesh në vendin e duhur në kohën e duhur. Dhe kam përshtypjen se kështu më

ndodhi mua. Para dy vjetësh isha në Tiranë. Shkova të takoja një shokun tim në lokalitë të tij. Ishte vonë dhe bari ishte bosh, ndërsa shoku im po pinte kafe me dy persona të tjerë. E përshëndeta, dhe u ula në një tavolinë pak larg tij. Ishte një mbrëmje e qetë, rutinë në kur nuk pret të ndodhë asgjë e veçantë. Por nuk kaluan as dy

Erdhën njëra pas tjetres ekspozitat në aktivitete të rëndësishme në Shqipëri, e më së fundi edhe pjesëmarrja në biennalen e Venecias së sivjetshme...

Po, edhe për këto duhet të them se janë gjëra që kanë rrjedhur disi në vazhden e rastësive fatlume. Thuhet shpesh herë se për disa gjëra duhet të ndodhesh në vendin e duhur në kohën e duhur. Dhe kam përshtypjen se kështu më ndodhi mua

minuta dhe dëgjova shokun tim të më thërriste, "hajde këtu në tavolinë me ne - më tha - njëri nga këta dy personat dëshiron të flasë me ty. Unë pa ndonjë interes të veçantë iu përgjigja, ok, nuk ma merrte mendja se ç'mund të ishte. Atëherë: përshëndetje, unë jam Andi më tha njëri prej tyre. Njo-vijon në faqen 16



vijon nga faqja 15

ha kështu Andi Tepelenën, drejtorin e Artkontaktit, që është shndërruar viteve të fundit në një pikë të rëndësishme referimi për artistët bashkëkohorë shqiptarë. Në fakt më pas mora vesh se ishte duke organizuar një festival të artit bashkëkohor në Sarandë këtë verë. Kuptohet që shfrytëzova rastin t'i flisja për punët e mia që kisha përfunduar dhe ato me të cilat po merresha në atë moment. Në kohë rekord më ftoi të merrja pjesë në festivalin që ishte duke organizuar në Sarandë, dhe unë mendova një projekt për ta paraqitur atje. Bëhej fjalë për një instalacion. Ishte një instalacion me karrige të ngjitura në portën e kalasë së Lëkursionit. Edhe pse ishte ekspozita ime e parë e këtij lloji, projekti pati aq sukses sa sot m'u besua edhe paraqitja e një projekti të pasojë pjesëmarrja në edicionin e sivjetshëm të Biennales së Venecias.

Instalacionet, janë një fazë e zbuluar së fundmi në punët e tua? Cili është formimi yt i mëparshëm?

Kam një formim më shumë akademik si gjithë artistët shqiptarë në përgjithësi që janë formuar në shkollat shqiptare. Të gjithë kalojnë përmes parimeve që synojnë të diçka për të plotësuar normat akademike. Por mua, e gjitha kjo pas një faro kohe mund të them se më rrinte ngushtë. Dhe për pasojë unë fillova të projektohesha jashtë saj, fillova në këtë mënyrë të kërkoja më shumë. Nuk dëshiroja të ndalesha në skulpturën klasike, pra atë të masës, të shesheve, me estetikë të thjeshtë e të drejtpërdrejtë që gjymton anën konceptuale të një pune. Unë kërkoja, dhe natyrisht vazhdoj t'i përmbahem këtij parimi, diçka më shumë, jashtë skulpturës, diçka filozofike, polemike, mbi temat sociale veçanërisht. Kjo sepse jemi në një moment kur kjo botë ka nevojë për të tilla ngacmime ndoshta më shumë se kurrë më parë në të kaluarën e kësaj pjese të botës ku ne jetojmë.

Por, si fillove të merreshe me instalacione duke u nisur nga eksperiencia akademike? Nuk është diçka automatike natyrisht. Cila ishte pak a shumë shtysa?

Po në atë sistem shkollor format e artit bashkëkohor dhe eksperimental nuk ishin të

RASTËSITË FATLUME TË KLODIAN DEDES



”

Që i vogël perceptoja një lloj interesi. Për shembull uleshja përballë televizorit për të ndjekur edicionin e lajmeve të orës tete. Në të vërtetë nuk ishte një zgjedhje e imja, siç mund të vetëkuptohet, isha më shumë i detyruar sepse atë e ndiqte babai im. Ndërsa unë me kureshtje e ndiqja për të tjera arsye. Pjesa më interesante e atyre lajmeve, të cilën mezi prisja të vinte, ishte në fund kur fliste për ndonjë ekspozitë që ishe hapur në Tiranë.



rrokshme lehtësisht e automatikisht. Mund të them se instalacioni lindi në mua duke zbuluar e njohur artistët bashkëkohorë. Ekziston një mekanizëm në metabolizmin artistik të individëve që merren me art, sipas të cilit, artisti mbledh, mbledh, e mbledh, dhe në një kohë të caktuar, atëherë kur vjen momenti për një projekt ai krijon një bagazh të tijin të vetëmjaftueshëm, prej nga burojnë idetë dhe ngacmimet. Kështu ndodh që vepra e radhës lind natyrshëm, e pothuaj vetvetiu.

Në ditët e sotme, në Shqipëri një artisti që dëshiron të inkadrohet në artin bashkëkohor, sipas teje i jepen mundësitë për të ndjekur këtë lloj arti?

Absolutisht jo, nuk ka se si të ndodhë. Dhe jam i sigurt se një gjë e tillë nuk do të ndodhë deri sa të largohen profesorët e sotëm, ne moshë të cilët mund të thuhet pa frikë se kanë bllokuar akademinë shqiptare.

Do të thuash se ndihet ende e kaluara, fryma e izolimit të regjimit komunist? Ende pas 20 vjetësh?

Për fat të keq po. Jo vetëm në hapësirat artistike ku atmosfera është mbytëse, por në çdo ambient institucional e politik.

Nuk është kjo diçka e çuditshme ende pas 20 vjetësh?

Në të vërtetë do të parapëlqejta të mos flisja shumë mbi këtë temë. Problemi ekziston dhe duhet qënë kritikë ndaj tij, nuk e mohoj. Por ndoshta jemi aq shumë të lodhur, i kemi shterur energjitë për tu marrë me këtë problem. Siç thotë Kadare, koha do të flasë për popullin shqiptar. Edhe në këtë prizëm unë do të thosha, le t'ia lëmë kohës.

Si ke hyrë në botën e artit?

Që i vogël perceptoja një lloj interesi. Për shembull uleshja përballë televizorit për të ndjekur edicionin e lajmeve të orës tete. Në të vërtetë nuk ishte një zgjedhje e imja, siç mund të vetëkuptohet, isha më shumë i detyruar sepse atë e ndiqte babai im. Ndërsa unë me kureshtje e ndiqja për të tjera arsye. Pjesa më interesante e atyre lajmeve, të cilën mezi prisja të vinte, ishte në fund kur fliste për ndonjë ekspozitë që ishe hapur në Tiranë. Më entuziazmonin ato ekspozita pa masë. Ndjeja diçka brenda edhe

vijon në faqen 19



MOS I VËR KUFIJ ZËRIT TËND.

Mjaftojnë 10 qindarka për t'u ndier në shtëpi.

Aktivizo Call Your Country: flet me Shqipërinë duke filluar nga 10 qindarka në minutë. Madje, me Noi Wind, me vetëm 6 euro në muaj mund të flasësh falas me të gjithë celularët Wind për 200 minuta në muaj.

Aktivizim falas për të gjithë klientët e rinj deri më 11 tetor 2009.

Call Your Country ka kosto gjashtëmujore prej 4 eurosh. Tarifa drejt celularëve është 10 qindarka në minutë. Impulsi i përgjigjes 15 qindarka. Tarifimi çdo 60 sekonda. Për informacione www.wind.it



WIND

abonohu në

Bota shqiptare

GAZETA E SHOIPTARËVE NË ITALI

fituese e çmimit m.souhir 2005 të gazetarisë italiane si "gazeta më e mirë për të huajt në itali"

"Bota shqiptare" është prej dhjetë vitesh i vetri zë në gjuhën shqipe në shtypin italian

"Bota shqiptare" botohet nga e vetmja shtëpi botuese në gjuhën shqipe në Itali

"Bota shqiptare" nuk ka përfituar e nuk përfiton asnjë kontribut financiar publik italian apo shqiptar.

"Bota shqiptare" është e pavarur dhe jeton vetëmsajë shitjeve, abonimeve dhe reklamave

PAJTOHU PËR VETE
apo për t'ia bërë dhuratë një miku

abonimi për një vit (22 numra)

€ 35.00

ABONIMI MUND TË FILLOJË NË ÇDO PERIUDHË TË VITIT
PAGESA KRYHET PRANË ÇDO SPORTELI TË POSTAVE ITALIANE
nëpërmjet derdhjes së një buletini postar pagese
në llogarinë postare (conto corrente postale)
nr. 16831018 në favor të BOTA SHQIPTARE

Telefono në redaksi dhe kërkto të të nisimnumin e parë bashkë me fletën e abonimit të plotësuar.
Më ta marrë, të mbetet veç të shkosh në postë për të paguar.



BOTA SHQIPTARE, VIALE MARCO POLO 119, 00154 ROMA

REDAKSIA DHE SHËRBIMI I ABONIMEVE TEL 06-57289240 - FAX 06-62209543 - CEL. 339-6426836

redaksia@botashqiptare.net

RASTËSITË FATLUME TË KLODIAN DEDËS

vijon nga faqja 16

sot e kësaj dite të papërku-
fizueshme lehtë.

Si lindin punët e tua?

Zakonisht kam një projekt. Bazohem përgjithësisht mbi të. Por kjo nuk do të thotë se shpesh nuk më nxisin gjëra që më dalin përballë pa prituri.

Nga vijjnë përgjithësisht shtytat? Për shembull tek vepra e karrigeve në portën e kalasë si ndodhi?

Tema në atë punë, ishte Nomadizmi si koncept. Por idenë e karrigeve për të bërë një punë e kisha kohë më parë. Duke u bazuar mbi temën vendosa karriget në rresht. Sepse të vendosura në atë mënyrë ato simbolizojnë karvanët e njerëzve që janë gjithmonë në lëvizje. Këtu krijohet kontrasti ndërmjet dy elementeve. Kalaja dhe toka janë ato të dyja që simbolizojnë ngritjen dhe zbritjen e këtyre njerëzve nga malet në fusha, nga fushat në male. Vete kalaja nga ana e saj është simbol i një bashkimi, mbledhjeje, strehe. Po ashtu edhe ngjyrat bartin simbolikën e vet. Kanë diçka që duan të transmetojnë. E kuçja simbolizon tokenë. Bluja ujin dhe qiellin, jeshilja frytin.

Si u realizua pjesëmarrja jote në Biennalen e Venecias? Ka dhënë ndihmesën e vet edhe shteti shqiptar?

Më erdhi një kërkesë nga Andi Tepelena, drejtori i Artkontaktit. Ndërsa për ndihmesën e shtetit shqiptar, si gjithmonë nuk mund të mos më vijë për të qeshur. Si në ekspozitën e Sarandës, për të cilën fola më parë ashtu dhe në Venecia kam qenë vetë unë që e kam sponsorizuar punën time. E bëj sepse dua të jem pjesë e botës së artit, të prodhoj diçka që lind nga unë. Tek e fundit nuk është diçka e tmerrshme e parë artistikisht. Për shembull Jackson Pollock shiste një pikturë të tijën për të blerë 20 birra. E rëndësishme është të prodhosh diçka dhe me ato mundësi që ke.

Si shpjgohet që shteti shqiptar ka një indiferencë të tillë?

Është faji i kulturës që mbizotëron në institucionet



”

Arti bashkëkohor që lind në Shqipëri vazhdon të jetë i varfër. Shqipëria në rang ndërkombëtar prezantohet gjithmonë me artistët jashtë saj.

shqiptare. Në qoftë se në bienalen e Venecias do të përfaqësoheshim me Miss Shqipërinë shtetarët do të ishin të gatshëm të paguanin edhe shifra marramendëse për një gjë të tillë. Por siç thashë më parë nuk do të doja të flisja mbi këtë temë.

Me se je paraqitur në Biennalen e Venecias?

Në Biennalen e Venecias u prezantova me një instalacion të krijuar në vend. Është një instalacion që formon 2 kube të futur njëri brenda tjetrit. E gjithë vepra prezantohet para publikut në ajër, 3-përmasore. Pra publiku mund ta shijojë punën duke i rënë rreth e rrotull. Janë 52 korniza ku secila simbolizon një rrugë-terren, një pikësyzim për t'u arritur. Jo të gjitha janë të një përfundimi në perspektivë. Pra janë disa

më të gjata dhe disa më të shkurtra. Titullohet "Duke shikuar mbrapa". E kam konceptuar si një lloj metafore. Sit ë thuash, rrugët tona janë si korridorët e hoteleve. Janë të gjatë dhe kërkon të shkosh në fund për të marrë ashensorin. Të duket sikur nuk përfundon ai korridor. Kthehesh mbrapa për të parë pjesën e rrugës që ke përshkuar për të kuptuar se dhe sa rrugë të ka mbetur.

Kështu mendoj janë dhe pikësyzimet tona, nganjëherë duhet të shohim mbrapa për të kuptuar çfarë na pret përpara.

Cilët artistë të shërbejnë kryesisht si pika referimi?

Felix Gonzales Torres thotë: unë jam këtu për të lënë një shenjë. Dhe një gjë te tillë ai e bëri dhe pse vdiq i ri. Më pëlqen Maurizio Cattelan dhe Jeff Koons. Mënyra se si prezantojnë punët e tyre. Bëjnë gjithmonë diçka që të diskutohet.

Çfarë mendon për artin bashkëkohor në Shqipëri?

Arti bashkëkohor që lind në Shqipëri vazhdon të jetë i varfër. Shqipëria në rang ndërkombëtar prezantohet gjithmonë me artistët që jetojnë e punojnë jashtë saj.

Duke dashur të bësh një bilanc, çfarë të ka ofruar Italia?

Në këto tre vitet e akademisë më ka afruar aq shumë sa e gjithë pjesa tjetër e jetës sime. Ndoshta sepse gjeta diçka që më parë e shijoja vetëm në sipërfaqe.

Bisedoi Marjola Rukaj





NGUCAJ & BEQIRAJ NË "PËRPLASJE BALLORE"

Në Biennalen e Venecias, gjithmonë në mënyrë jo institucionale marrin pjesë edhe Arta Ngucaj dhe Ben Beqiraj. Me një projekt që vazhdon të sjellë mesazhe konceptuale që vërtetohen rreth konceptit të klandestinitit, migrantëve dhe botëve të ndërmjetme ku ata lëkunden.

Në Biennalen e Venecias, gjithmonë në mënyrë jo institucionale marrin pjesë edhe Arta Ngucaj dhe Ben Beqiraj. Me një projekt që vazhdon të sjellë mesazhe konceptuale që vërtetohen rreth konceptit të klandestinitit, migrantëve dhe botëve të ndërmjetme ku ata lëkunden. Edhe këtë herë ekspozita ka qenë me shumë konceptuale se fizike dhe ka zënë vend në kopshtet përpara godinave ku janë montuar veprat e artistëve pjesëmarrës së Biennales. Janë

objekte të vogla, të ndërthuruara me njëri-tjetrin për të dhënë një copë Shqipërie, e një copë nga bota e klandestinitëve të përtej detit. Kjo ekspozitë përmban thelbin e projektit me të cilin dy artistët janë duke u marrë prej viti 2007, dhe që titullohet Trafik, një trafik arti klandestin që sjell me të njëjtat mjete klandestine nga brigjet shqiptare jo më njerëz të dëshpëruar por pjesëza arti. Ky projekt madje së fundmi është shpërblyer edhe me një çmim në konkursin italian të titulluar

Nuove Arti, promovuar nga Muzeu i artit bashkëkohor të Bolonjës Mambo, dhe Fondazione-t del Monte të Ravenes. I sapodalë nga ky konkurs është pikërisht projekti me të cilin dy artistët shqiptarë janë paraqitur në biennalen e Venecias.

Elementet kryesore të veprës janë simbole të lidhjes dhe komunikimit ku si gjithmonë në projektin Trafik nuk mungon as deti që të dy artistët vlonjatë e kanë aq për zemër për të përkufizuar Shqipërinë prej

nga vijnë, por edhe komunikimin ndërmjet tokës prej nga kanë ardhur dhe tokës pa det ku janë stabilizuar e jetojnë sot në Italinë kontinentale të Bolonjës. Sendet që përfaqësojnë veprën e dy artistëve shqiptarë, gjenden në të hapur mes shumë veprash, e objektsh ekcentrike në atë park arti që është shndërruar Venecia këto muaj. Njihen lehtë për shkak të stemave shqiptare të stampuara në kufje, që simbolizojnë disi lajme, komunikim me anën tjetër të përtej detit.

SuperEnalotto

SuperEnalotto është një lojë e thjeshtë dhe zbatimëse e bazuar në numra. Mund të luash çdo ditë jave dhe rezultatet jepen çdo të martë, të enjte dhe të shtunë. Cila do të jetë dita jote me fat?

Është kollaj të luash dhe është e lehtë të fitosh!

A e dije se të luash dhe të fitosh në SuperEnalotto është tepër e thjeshtë? Zgjidh 6 numra nga 1 deri në 90 dhe gjej cilët do të jenë numrat me fat. Zgjidh numrat që ke dëshirë të luash në dy panelet që gjenden në skedinë: ke 5 mundësi të mira për të fituar, duke gjetur 6, 5 + numrin zhol (jolly), 5, 4 ose 3 numra të nxjerrë. Mund të fitosh shpesh: çdo javë ka tre konkurse për të trefishuar zbatimin tënde. Luaj të paktën 1 euro, dhe do të kesh mundësi të fitosh shumë më tepër!

SuperStar dhe Giocata Magica: shumëfishoje fatin!

Por nuk mbaron me kaq. Vetëm me 0,50 euro më shumë mund të zgjedhësh variantin SuperStar dhe të zbatimesh akoma më shumë. Në qoftë se gjen numrin SuperStar, i cili del automatikisht në momentin e luajtjes, i shumëfishon fitoret tuaja me 6, 5, 4 ose 3 numrat e nxjerrë që ke gjetur, por jo vetëm kaq: mund të fitosh edhe me 2, 1 ose 0! Loja minimale SuperEnalotto është gjithmonë 1 euro, dhe mund të vendosësh të çiftosh SuperStar me njërin ose me të dy panelet e lojës. Dhe me Giocata Magica, zgjedh një pjesë loje me 1, 2, 5 ose 10 euro: terminali në lokalet e lotarisë (ricevitoria) do të zgjedhë për ty kombinimin e rastësishëm e të 6 numrave me fat, të çiftuar me SuperStar.

Mos humb asnjë rast për të fituar!

Çdo hedhje në short mund të jetë ajo që duhet. Në qoftë se zgjedh Abonimet mund ta përsëritësh lojën për 2, 3, 4, 5, 6, 9 konkurse (3 javë), 12 konkurse (4 javë) ose 15 konkurse (5 javë). Dhe me Sistemet, ke tipologji të ndryshme lojërash ndërmjet Sistemeve të Reduktuar e Bazë dhe Variante: shumë kombinacione dhe shumë mundësi për të vazhduar të zbatimesh!

A i ke zgjedhur numrat e tu me fat?

Mos prit më! Mendo numrat që për ty kanë një kuptim të veçantë: për shembull, numrat me fat sipas traditës së vendit tënd. Ose një datë të rëndësishme, ditëlindjen e një personi të dashur, një ëndërr. Zbavit duke zgjedhur kombinimet për të luajtur: mund të jenë numrat e saktë për të fituar! Dhe në qoftë se blen kuponët me kombinimet e prodhuara automatikisht në momentin e lojës në lokalitë të lotarisë (ricevitoria), do të zbatimesh akoma më shumë: duhet vetëm të vendosësh shumën që do të luash dhe të provosh emocione duke e lënë veten krejtësisht në dorë të fatit!

Blej menjëherë një lojë: gjej SuperEnalotto në të gjitha lokalet e lotarisë (ricevitorie) Sisal.



Sisal nuk është vetëm një ndërmarrje që organizon lojërat por edhe një rrjet shërbimesh për qytetarët me një ofertë komplekse dhe të artikuluar e cila sot përbëhet nga rreth 230 shërbime aktive. Shumë nga këto shërbime janë futur në rrjetin tonë të lokaleve të lotarisë (ricevitorie) për t'ju përgjigjur më mirë kërkesave e të huajve në Itali, ndërmjet të cilave: rimbushjet për telefoninë e lëvizshme (celularët), kartat telefonike ndërkombëtare me garanci dhe leverdi më të madhe, shërbimin e transfertës së parave (money transfer) për transferimin e parave në kohë reale në të gjithë botën dhe dërgimin e zarfeve dhe të pakove për të gjitha destinacionet në Itali dhe jashtë shtetit.



Luaj sot. Bëhu milioner.



Me çfarë punësh keni ek-spozuar ne Biennale?

Ne Biennalen e Venecias kemi marrë pjesë me një performancë instalacioni të titulluar "Collisione Frontale", të mbështetur financiarisht nga Provinca e Bolonjës dhe me tekstin kritik të Stefano Taccone. Puna e Biennales është vazhdimësia e operacionit artistik "Trafik" që nis nga 2007 duke arritur në një përplasje (metaforike) me institucionin nga i cili merr dhe titullin instalacioni i realizuar në Venecia d.m.th "Collisione Frontale". Akti i kryerjes së instalimit të punës në brendësi të kopshtit të biennales ishte krejtësisht klandestin, ashtu siç ka qenë dhe mbetet boshti qendror i konceptit të punës sonë. Aksioni artistik konsistonte në ndërhyrjen ilegale në brendësi të institucionit të Biennales, me instalimin e një kufjeje wireless që transmeton pafundësisht një sinjal S.O.S të përcjellë nga një litar detar (konceptualisht), i cili i lidhur tek kufjet, përfundon në det. Ky instalim u realizua tek ura lidhëse midis



pavioneve të lindjes me ato të perëndimit mbi kanalën e Shën Elenës në Venecia.

Pse kjo zgjedhje, cili ka qenë mesazhi që keni dashur të përcillni?

Gjithë aksionet që kemi kryer kanë si bosht estetik dhe konceptual temën e klandestinitetit mbi të cilën duhet reflektuar akoma shumë, sidomos për rrjedhojat dhe pasojat e saj jo vetëm në terma shoqërore por edhe politike, kulturore dhe ekonomike. Qëllimi kryesor në këtë vepër artistike është vizioni ose sinjalizimi për "botë të tjera" që ekzistojnë fuqishëm në limitin e të dukshmes dhe të padukshmes kundrejt institucioneve.

Në punët tuaja të fundit është një temë kryesore klandestiniteti dhe dyfaqësia e migruarëve, pse kaq e rëndësishme kjo temë? Sa lidhet kjo me realitetin që ju jetoni në Italinë e sotme?

Psikoza e klandestinitetit ka qenë dhe ngelet një temë

vijon në faqen 22

SuperEnalotto

Është më kollaj të fitosh në SuperEnalotto se sa të lindësh me fat.



Fati është njësoj për të gjithë.
Mjafton të luash SuperEnalotto,
çdo të martë, të enjte e të shtunë.
Mos prit më, kërkoje fatin tënd në të gjitha
lokalet Sisal (ricevitoria) ku luhet lotaria.

Luaj sot. Bëhu milioner.



Luaj me përgjegjësi.

NGUCAJ&BEQIRAJ NË "PËRPLASJE BALLORE"

vijon nga faqja 21

shumë aktuale në Itali falë përkujdesjes që kushtohet nga ana e medias. Por nëqoftëse duhet ta mendojmë thellë, vetë termi klandestin është një paradoks me fenomenin e "globalizimit" ku liria e kalimit të mallrave korrespondon me limitin konstant të tranzitit të individëve. Pastaj, vetë pozicioni i Shqipërisë kundrejt Evropës është akoma i tillë, dhe kjo jo vetëm nga ana politike.

Në Biennale morët pjesë me ndihmën e shtetit shqiptar?

Istucionet shqiptare kanë mbështetur gjithmonë projektet tona nga ana konceptuale por asnjëherë deri tani nga ajo financiare, pa të cilën projekti sigurisht s'mund të realizohet.

Mendojmë se shteti Shqiptar nuk duhet të jetë aspak indiferent, sepse vetë momenti historik dhe metamorfoza që po pësojmë mund të fiksohet në memorijen kolektive shumë bukur vetëm nëpërmjet artit dhe çfarëdolloj rryme kulturore të mirëfilltë. Shteti jonë është ndoshta ende i brishtë dhe i pa aftë të kuptojë rëndësinë shoqërore, artistike dhe politike që mbart arti dhe kultura në ndryshimin dhe forcimin e imazhit të vet në botë. Pra me vlerësimin dhe mbështetjen e artit dhe artistëve të vet, do përgatiste pasaportën më të vlefshme dhe më të fuqishme për t'ju paraqitur Evropës me një tjetër portret nga ai i ofruar prej mediave të huaja. Por për fat të keq artistëve shqiptarë iu duhet të përshkojnë rrugën e artit mes sfidave të ndryshme të tregut botëror pa pasur mbështetjen e shtetit, në ndryshim nga të gjithë artistët e shteteve të tjera.

Ky problem mund të zgjidhet vetëm falë një kontributi të mediave shqiptare për sensibilizimin e institucioneve përkatëse rreth problemit në mënyrë të tillë që shteti shqiptar të marrë përsipër këtë përgjegjësi.

Marjola Rukaj



Robert Aliaj Dragot është një nga artistët më të afirmuar me origjinë shqiptare, që merr pjesë në edicionin e tanishëm të Biennales së Venecias. Pas një eksperience të rëndësishme në sferën e muzikës, artisti shqiptar i është kthyer lëvrimit të arteve pamore në përputhje me formimin e tij bazë. Fillimisht piktura, dhe më pas instalacionet, e videoinstalacionet janë kryesisht mediet e përzgjedhur prej tij. Ndërsa mesazhet dhe tematikat janë të larmishme, e mbresëlënëse duke u lëkundur sa në të kaluarën shqiptare me grotesken, çudinë e manitë e panumërta deri, sa në të tashmen të mbushur me paradokse dhe ndjesi negative që nuk kanë si të mos pezmatojnë artistët dhe idealistët parimorë të çfarëdolloj orientimi. Por nuk mungojnë edhe elementet e përditshmërisë me detajet dhe sjelljet rëndom të marra për të mirëqena e që i shpëtojnë syrit të zakonshëm të përfshirë në rutinën e mërzitshme.

Në biennalen e Venecias paraqitet me një videoinstalacion të përfutur nga copëza filmash të publikuara në youtube të cilat kanë pavdekësuar episode rrëqethëse dhune dhe poshtërimi, në skena të tmerrshme, edhe pse të nxjerra nga kon-

teksti ku policët grekë detyrojnë të arrestuarit shqiptarë të keqtrajtojnë njëri-tjetrin në mënyrë absurde. Janë të ndryshme arsyet pse një vepër e tillë të bën të meditoesh, që nga dhuna e induktuar, përdhuna, ksenofobia e marrëdhëniet ndërmjet dominuesit dhe të dominuarit, por edhe marrëdhëniet e njeriut me teknologjinë e masave, dhe pasojat që masivizimi i teknologjisë ka sjellë në përcimin e imazhit në të mirë e në të keq duke sfiduar filtrat. Mbeten të shumta këndvështrimet prej nga mund të vrojtohet vepra "6080K310i" Episode 1.

